

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L

**Për: KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	<b>614-26-3885-5-2-1</b>
------------------------------	--------------------------

Titulli: **Punët dhe Shërbimet Emergjente në DSHPE**

**EE- TECH SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr. Fehmi Lladrovci**

(Adresa)

**FUSHË KOSOVË**

(Vendi)

**12000**

(Kodi postar)

**043500466**

(Numri Telefonit)

**N/A**

(Numri i Faks-it)

**Sali Grajgevc**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**office@ee-tech.net**

(Adresa elektronike)



**08.07.2026**

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 22.05.2026  
Procesverbali i hapjes: 15.06.2026  
Njoftimi mbi vendimin e AK: 23.06.2026  
Kërkesa për qasje në dokumentacion: 24.06.2026, Qasja NUK është ofruar:  
Kerkese per rishqyrtim: 29.06.2026  
Vendimi i AK ne kërkesën per rishqyrtim: 01.07.2026  
Ankese ne OSHP: 08.07.2026

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesverbalin e hapjes e kemi pranuar përmes sistemit të E-prokurimit.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 – Qëllimi:** Ky nen përcakton qëllimin e ligjit, i cili është të rregullojë procedurat për prokurimin publik në mënyrë të drejtë, transparente dhe konkurruese.

**Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti:** Autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorim sa më efikas dhe ekonomik të fondeve publike gjatë procesit të prokurimit.

**Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi:** Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa diskriminim në asnjë fazë të procedurës së prokurimit.

**Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve:** Përcakton rregullat dhe kriteret për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë.

**Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale:** Kërkesat për dëshmimin e aftësive teknike dhe profesionale që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë për të qenë të kualifikuar për kontratën përkatëse.

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Te nderuar,

Me date 23.06.2026 permes platformes elektronike jemi njoftuar se ne EE- TECH SH.P.K. jemi eliminuar edhe pse kemi qene te pergjegjshem dhe kemi qene me te lire, AK ka

rekomanduar per kontrate Grupin e Operatoreve Ekonomik VJV GROUP L.L.C;  
EUROTRANS SH.P.K. ., me cmimin me te larte.

Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, dhe në bazë të nenit 108A të këtij ligji, ne si Operator Ekonomik parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit për eliminimin tonë nga procedura e prokurimit, pasi konsiderojmë se ky vendim është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe parimet themelore të prokurimit publik.

Fillimisht theksojmë se ne si OE pjesëmarrës ne kete procedure te prokurimit, pas njoftimit mbi vendimin e AK, kemi ushtruar te drejtën ligjore per qasje ne dokumentacionin e Operatoreve Ekonomik qe kane marre pjese,

Ne përputhje me nenin 7 te LPP-se, i cili garanton transparence gjate zhvillimit te procedurave te prokurimit, me nenin 5 qe përcakton trajtimin e barabarte te te gjithë pjesëmarrësve, me nenin 10 qe rregullon parimet e ekonomicitetit dhe konkurrencës se hapur, si dhe me nenet 108A dhe 109 te LPP-se, qe sigurojnë mundësinë e shqyrtimit te dokumentacionit dhe ushtrimit te mjeteve juridike, pavarësisht kësaj baze ligjore, Autoriteti Kontaktues nuk ka ofruar qasje ne dokumentacionin e OE pjesëmarrës, duke na pamundësuar verifikimin e ofertave ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit

Mungesa e qasjes ne dokumentacion nga Zyra e Prokurimit/AK, pavarësisht kërkesës se rregullt dhe te bazuar ne dispozita ligjore, iu kan shmangur detyrimeve per transparence dhe trajtim te barabarte, duke ngritur dyshime mbi rregullesine dhe paanshmërinë e zhvillimit te kësaj procedure.

Pretendimet e AK- se ndaj ofertës sonë se nuk i kemi plotësuar kërkesat per pajisjet dhe nderkohe Zyra e Prokurimit/AK nuk ofron qasje ne dokumentacionin ekuivalent te OE, na ka pamundësuar qe dokumentacioni i OE ti nënshtrohet kontrollit te palës se interesuar.

**Pra qasja qe nuk eshte ofruar nga Zyra e Prokurimit, eshte pikërisht ai dokumentacion mbi bazën e te cilave EE- TECH SH.P.K. eshte eliminuar. Pa qasje ne nuk mund te verifikojmë se OE i rekomanduar per kontrate i ka përmbushur te njëjtat kërkesa dhe nëse AK ka zbatuar standard te njejte vlerësimi.**

**Neni 10.3 i LPP-së** obligon AK-në që, me kërkesë me shkrim të palës së interesuar, të sigurojë qasje të arsyeshme në dokumentacionin e aktivitetit, përveç informatave që vërtetohen ligjërisht si sekrete afariste.

**Neni 10.4** kërkon që qasja të sigurohet në mënyrë të rregullt, të qetë dhe pa pengesa, ndërsa

**Neni 10.5** kërkon dhënie e kopjeve të materialit në të cilin pala ka të drejtë qasjeje.

**Mosofrimi i qasjes në dokumentacion nuk është çështje interpretimi, por mosrespektim i detyrimeve ligjore që rregullojnë transparencën në procedurat e prokurimit publik.**


- Në mungesë të një analize dhe të bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, arsyet e eliminimit të tyre të paraqitura nga AK mbështeten në vlerësim selektiv dhe jo në gjendjen reale të dosjes së tenderit, andaj në vijim paraqesim argumentet tona ndaj secilit pretendim të ngritur.
- Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim:

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se EE-TECH SH.P.K. është njoftuar për realizimin e qasjes në dokumentacion nuk qëndron dhe nuk është mbështetur me prova konkrete.

Kërkesën për qasje në dokumentacion e kemi paraqitur përmes platformës së e-Prokurimit, e cila është platforme zyrtare e komunikimit në procedurën e prokurimit. Prandaj edhe përgjigjja e Autoritetit Kontraktues është dashur të komunikohet përmes të njëjtës platforme, në mënyrë që njoftimi të ishte i rregullt, transparent dhe i verifikueshëm.

Autoriteti Kontraktues pretendon se njoftimin për realizimin e qasjes e ka dërguar përmes postës elektronike, mirëpo nuk ka paraqitur asnjë provë se ky njoftim është dorëzuar dhe është pranuar nga EE-TECH SH.P.K. Vetë pretendimi se një email është dërguar nuk dëshmon se ai ka arritur të marrësi.

Në rastet kur një email nuk mund të dorëzohet, sistemi i postës elektronike gjeneron automatikisht njoftim për mosdorëzim (*Delivery Failure* ose *Undelivered Mail Returned to Sender*), gjë të cilën Autoriteti Kontraktues mund ta verifikojë lehtësisht. Nuk mund të konsiderohet se EE-TECH SH.P.K. është njoftuar në mënyrë të rregullt për datën dhe orën e realizimit të qasjes sepse ne nuk e kemi pranuar këtë email. Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se EE-TECH SH.P.K. nuk është paraqitur në terminin e caktuar është i pabazuar pasi mungesa e qasjes ka ardhur si pasojë e moskomunikimit në platformën e-prokurimi aty ku e kemi bërë edhe kërkesën për qasje!



## **Pretendimi 1**

Sa i përket eskavatorit me goma, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për mungesë të librezës së regjistrimit nuk qëndron, pasi për këtë pajisje në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar shprehimisht detyrimi për librezë si kërkesë individuale, ndërsa pajisja është e dëshmuar me dokumentacion pronësie DUD në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Kontraktues për mungesën e librezës së regjistrimit për eskavatorin me goma, sqarojmë se ky pretendim është i pabazuar.

- EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokumentacionin përkatës për dëshmimin e posedimit të pajisjes, përkatësisht dokumentin DUD, i cili dëshmon pronësinë mbi eskavatorin me goma. Autoriteti Kontraktues ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar kërkesën e Dosjes së Tenderit, duke e konsideruar eskavatorin me goma si pajisje që kërkon domosdoshmërisht librezë regjistrimi, pa dhënë një arsyetim konkret se në bazë të cilit dokument apo dispozite kjo pajisje hyn në kategorinë e pajisjeve që regjistrohen.

Edhe pse Dosja e Tenderit përcakton se pajisjet që regjistrohen duhet të dëshmohen me librezë regjistrimi, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të vlerësojë nëse pajisja konkrete – eskavatori me goma – i nënshtrohet këtij detyrimi dhe të arsyetojë qartë këtë qëndrim gjatë procesit të vlerësimit.

Në mungesë të një sqarimi të tillë dhe duke pasur parasysh se EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokument që dëshmon pronësinë dhe posedimin e pajisjes, eliminimi i ofertës vetëm për shkak të mungesës së librezës së regjistrimit paraqet interpretim të zgjeruar të kërkesave të Dosjes së Tenderit.

## **Pretendimi 2.**

Lidhur me mini bagerin, sqarojmë se pajisja me peshë 3.6 ton është paraqitur gabimisht në ofertë, ndërsa pajisja tjetër sipas kërkesës e deklaruar në listën e pajisjeve të dorëzuar nga ne është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me këtë pajisje, i njëjti ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në përputhje me nenin 59 të LPP-së, dhe ne do të kishim dorëzuar dokumentacionin përkatës pa asnjë ndryshim në substancën e ofertës.

-Lidhur me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se EE-TECH SH.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën për mini bagerin me minimum 4.5 ton, ky pretendim është i pabazuar.

Në listën e pajisjeve të dorëzuar në ofertë nga EE-TECH SH.P.K. është deklaruar mini bageri që përmbush kërkesën minimale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përkatësisht minimum 4.5 ton.

Lista e Pajisjeve			
	Lista e Pajisjeve	Pronesia	marveshja
1	Eskavato me goma min 14 ton	Muhamet Preniqi	marveshja
2	Mini bager min 4.5ton	Gentrir Preniqi	marveshja
3	Kamion kiper min 10ton	Lulzim Preniqi	marveshja
4	Rimorkio	Lulzim Preniqi	marveshja
5	Ngjestore te rruge min 60kg	Muhamet Preniqi	marveshja
6	Kompresor hillt	Muhamet Preniqi	marveshja
7	Sharr dore (trimer) ndryshe nga ato me zingjir apo me disk	Muhamet Preniqi	marveshja
8	Shkall alumini	Muhamet Preniqi	marveshja
9	Traktor me kabitë për hapësirë të ndryshme	Muhamet Preniqi	marveshja
10	Auto larje vetë levizëse	Muhamet Preniqi	marveshja
11	Motorr sharr për prerjen e drunjtëve	Muhamet Preniqi	marveshja
12	Fshisë për pastrimin e trotuarve	Muhamet Preniqi	marveshja

Ne listen e pajisjeve eshte i paraqitur dhe deklaruar mini bageri 4.5 ton, nese AK, ka pasur paqartesi, eshte dashur te kerkoj sqarime shtese.

Mospërputhja e pretenduar në një dokument tjetër nuk mund të merret e shkëputur nga pjesa tjetër e dokumentacionit të ofertës. Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me dokumentet e dorëzuara, ka qenë e nevojshme të kërkohet sqarim në përputhje me nenin 59 të LPP-së, pasi kjo do të kishte të bënte me sqarimin e dokumentacionit ekzistues dhe jo me ndryshimin e ofertës.

Eliminimi i ofertës së EE-TECH SH.P.K. vetëm mbi bazën e kësaj mospërputhjeje është i pabazuar.

### Pretendimi 3.

Sa i përket rimorkio per bartjen e bagerave, dokumentacioni i dorëzuar përfshin librezën e regjistrimit në përputhje me kërkesat të FDT-së, andaj pretendimi për mungesë dokumentacioni nuk qëndron, Në rast se Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me 'FAQET E LIBREZAVE', i njëjti ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në përputhje me nenin 59 të LPP-së, dhe ne do të kishim dorëzuar dokumentacionin përkatës pa asnjë ndryshim në substancën e ofertës.

Lidhur me pretendimin për rimorkion për bartjen e bagerave, vërejmë se Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar arsyetimin e eliminimit në krahasim me vendimin e parë.

Në vendimin fillestar, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se EE-TECH SH.P.K. nuk ka dëshmuar faqet e librezës qarkulluese për rimorkiot me targa 01-695-BV dhe 01-784-BV, ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim ka paraqitur një arsye tjetër, duke pretenduar se rimorkioja e paraqitur nuk është e destinuar për bartjen e bagerave.

Ky ndryshim i arsyetimit tregon se vlerësimi nuk ka qenë i qartë dhe i qëndrueshëm. EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokumentacion për pajisjen e deklaruar në ofertë, ndërsa në rast të ndonjë paqartësie lidhur me dokumentet e dorëzuara, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarim në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Arsyetimi i dhënë në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim nuk mund të përdoret si bazë për eliminim, pasi paraqet një vlerësim të ri që nuk është dhënë në vendimin fillestar.

### Arsyetimi i AK në vendimin e pare:

**3. Rimorkio për bartjen e bagerave keni ofruar 2 rimorkio librezë me targa: 01-695-BV dhe 01-784-BV 372kg, oe nuk e ka deshmuar fare faqet e librezën qarkulluese.**

### Arsyetimi i AK në vendimin e dyte:

Përgjegje lidhur me pretendimin 4 të Operatorit Ekonomik është I PA BAZUAR  
Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në Dosjen e Tenderit rimorkio për bartjen e bagerave, si pajisje minimale teknike e nevojshme për realizimin e kontratës.  
Gjatë vlerësimit të ofertës është vlerësuar se ju , në folderin e pajisjeve, faqe 17, keni dorëzuar DUD-in për një rimorkio me këto të dhëna:

- Marka: Cheval Liberté;
- Tipi: C2 BBA GBC;
- Peshë: 928 kg.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezultojnë se pajisja e paraqitur është një rimorkio e lehtë dhe nuk dëshmon se bëhet fjalë për rimorkio të destinuar për bartjen e bagerave, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, dokumentacioni i dorëzuar nuk verteton përmbushjen e kërkesës minimale teknike të Autoritetit Kontraktues.

Pretendimi juaj se Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë sqarime sipas nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik nuk qëndron. Neni 59 i LPP-së lejon vetëm sqarimin e dokumenteve ekzistuese dhe jo plotësimin, zëvendësimin apo ndryshimin e përmbajtjes së ofertës ose të pajisjeve të ofruara. Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me një paqartësi formale, por me mosdëshmimin e përmbushjes së një kërkesë minimale teknike.

Në DUD shihet qartë se rimorkio ka kapacitet vetëm 928 kg, një rimorkio me këtë kapacitet nuk mund të përdoret për bartjen e një bageri prej disa tonësh, gjë që tregon qartë se pajisja e ofruar nuk i përgjigjet kërkesës së Dosjes së Tenderit.

### Pretendimi 4.

Lidhur me rimorkion

Nuk është kërkuar shprehimisht detyrimi për librezë si kërkesë individuale, ndërsa pajisja është e deshmuar me dokumentacion pronësie DUD në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pretendimi për rimorkion për bartjen e bagerave, sqarohet se Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar arsyetimin e eliminimit në dy vendime të ndryshme.

**Në vendimin fillestar**, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se EE-TECH SH.P.K. ka paraqitur një rimorkio të markës **Cheval Liberté**, tipi **C2 BBA GBC**, por se ajo nuk ishte e regjistruar sipas kërkesës. **Ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim**, Autoriteti Kontraktues ka dhënë një arsyetim tjetër, duke pretenduar se rimorkioja e paraqitur nuk është e përshtatshme për bartjen e bagerave për shkak të peshës prej 928 kg.

Ky ndryshim i arsyetimit tregon se vlerësimi i ofertës nuk ka qenë i njëjtë dhe i qëndrueshëm në Dosjen e Tenderit është kërkuar vetëm "rimorkio për bartjen e bagerave", pa u përcaktuar

ndonjë kriter teknik lidhur me kapacitetin, peshën apo karakteristikat tjera minimale që duhet t'i përmbushë kjo pajisje.

EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokumentacionin për rimorkion e deklaruar në ofertë dhe ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. **Autoriteti Kontraktues nuk mund të vendosë gjatë fazës së vlerësimit kërkesa shtesë teknike të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit.**

Eliminimi i ofertës së EE-TECH SH.P.K. mbi bazën e një kriteri që nuk është kërkuar në Dosjen e Tenderit është i pabazuar.

**Pretendimi 5.** Lidhur me Kompresorin Hillt, kërkesa për libeze regjistrimi për këto pajisje nuk perputhet me natyrën e saj teknike, behet fjale për pajisje pune ndertimore dhe jo për mjet transportues që i nënshtrohet regjistrimit në qarkullim rrugor. Kjo Pajisje ndertimore është e deshmuar me dokument pronesie DUD, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pretendimi për Kompresorin Hilti, vërehet se Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar arsyetimin e eliminimit në krahasim me vendimin fillestar.

Në vendimin fillestar, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se EE-TECH SH.P.K. nuk ka dëshmuar librezën e qarkullimit për këtë pajisje, ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se çështja e librezës është irelevante dhe se arsyeja e eliminimit lidhet me faktin se pajisja e paraqitur nuk është ajo e kërkuara.

Ky ndryshim i arsyetimit tregon se Autoriteti Kontraktues nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë dhe të qartë gjatë vlerësimit të ofertës. Nëse arsyeja e eliminimit ka qenë mospërputhja e pajisjes së ofruar, kjo është dashur të paraqitet qartë në vendimin fillestar, e jo të ndryshohet vetëm pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

EE-TECH SH.P.K. ka paraqitur dokumentacionin për pajisjen e deklaruar në ofertë, ndërsa Autoriteti Kontraktues është dashur të vlerësojë ofertën mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të japë arsyetim të qartë dhe të qëndrueshëm për vendimin e marrë.

Ndryshimi i arsyetimit nga mungesa e librezës së regjistrimit në mospërputhjen e pajisjes së ofruar paraqet një vlerësim jo të qëndrueshëm dhe cenon transparencën e procesit të vlerësimit, nderkohe në kërkesat e dosjes së tenderit nuk ka pasur peshe specifike.

Gjithashtu, në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar asnjë kërkesë lidhur me kapacitetin apo specifikime të tjera teknike për Kompresorin Hilt.

#### **Arsyetimi i AK në vendimin e parë:**

5. Kompresor hiltt nuk kemi arritur ta deshmoni librezën e qarkullimit sipas kërkesës së FDT-ës por vetëm një dud

## Arsyetimi i AK ne pergjigjet e kerkeses per rishqyrtim:

### **Përgjegjje lidhur me pretendimin 5 të Operatorit Ekonomik është I PA BAZUAR**

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar Kompresor Hilti si pajisje minimale teknike. Gjatë shqyrtimit të ofertës është konstatuar se Operatori Ekonomik, në PDF "Pajisjet", faqe 11, ka paraqitur Minikompresor 120 bar, marka FALCH, modeli R1/2PC, i cili nuk përputhet me pajisjen e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, pretendimi i juaj lidhur me nevojën ose jo të librezës së regjistrimit është irelevant për këtë çështje, pasi arsyeja e eliminimit nuk ka të bëjë me dokumentacionin e regjistrimit, por me faktin se pajisja e ofruar nuk është ajo e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në këtë rast shtrohet pyetja: a është relevante mungesa e librezës së regjistrimit apo jo? Nëse, sipas vetë Autoritetit Kontraktues, çështja e librezës është irelevante, atëherë ajo nuk mund të përdoret si arsye për eliminim. Ndërsa, nëse kërkohet dëshmia e regjistrimit, atëherë Autoriteti Kontraktues duhet të mbajë të njëjtin qëndrim dhe të arsyetojë qartë bazën e eliminimit.

### **Pretendimi 6.**

Lidhur me pajisjen Sharre dore (trimer) ndryshe nga ato me zingjir dhe disk, Për këtë pajisje është dorëzuar dokumentacioni përkatës DUD-i, në të cilin qartë është e specifikuar si 'Makine dore elektike- Sharre', pretendimi për mungesë të dëshmisë nuk qëndron, pasi pajisja është e identifikuar qartë dhe e dokumentuar në përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit.

Lidhur me pajisjen "Sharrë dore (trimer) ndryshe nga ato me zinxhir apo disk", vërehet se Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar arsyetimin e eliminimit në krahasim me vendimin fillestar.

Në vendimin fillestar, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se EE-TECH SH.P.K. nuk ka ofruar fare dëshmi për këtë pajisje, ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim pranon se është dorëzuar dokumentacioni (DUD), por pretendon se pajisja e ofruar nuk përputhet me kërkesën teknike.

Pra, vetë Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar bazën e arsyetimit, nga mungesa e dokumentacionit në mospërputhje teknike të pajisjes së paraqitur. Një ndryshim i tillë i arsyetimit pas vendimit fillestar tregon se vlerësimi nuk ka qenë i qartë dhe i qëndrueshëm.

EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokumentacion për pajisjen e deklaruar në ofertë, ndërsa nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me natyrën ose karakteristikat e pajisjes, kjo

është dashur të vlerësohej mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar dhe, nëse ishte e nevojshme, të kërkohej sqarim sipas nenit 59 të LPP-së.

Ndryshimi i arsytimit nga "mungesë dëshmie" në "mosplotësim të kërkesës teknike" paraqet një vlerësim jo të qëndrueshëm nga Autoriteti Kontraktues.

### Arsytimi i AK ne vendimin e pare:

#### 6. Sharr dore (trimer) ndryshe nga ato me zingjir apo disk, nuk keni ofruar fare dëshmi për këtë

### Arsytimi i AK ne vendimin e dyte:

#### Pretendimi 6.

Lidhur me pajisjen Sharre dore (trimer) ndryshe nga ato me zingjir dhe disk, Për këtë pajisje është dorëzuar dokumentacioni përkatës DUD-i, në të cilin qartë është e specifikuar si 'Makine dore elektike- Sharre', pretendimi për mungesë të dëshmisë nuk qëndron, pasi pajisja është e identifikuar qartë dhe e dokumentuar në përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit

#### Përgjegjje lidhur me pretendimin 6 të Operatorit Ekonomik është I PA BAZUAR

Përdorimi i termit "trimer" në kllapa shërben për të sqaruar qartë llojin e pajisjes që kërkohet. Në kuptimin teknik dhe në përdorimin e zakonshëm, trimeri është pajisje e destinuar për prerjen e barit, shkurreve dhe vegjetacionit. Trimerët zakonisht përdorin pe najloni, ndërsa disa modele mund të pajisen edhe me disk ose zinxhir. Megjithatë, AK ka specifikuar se kërkohet trimer "ndryshe nga ato me zinxhir apo me disk", çka nënkupton se janë përjashtuar modelet me zinxhir dhe me disk dhe se kërkohet trimer me pe najloni. Për rrjedhojë, sharra me disk për prerje betoni e ofruar nga OE nuk i përgjigjet kërkesës teknike, pasi nuk është trimer dhe për më tepër është pajisje me disk, kategori e përjashtuar pikërisht nga vetë specifikimi i AK-së.

#### Pretendimi 7.

Pajisja e paraqitur me DUD si traktor me kositëse është pajisje pune për mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra dhe nuk i nënshtrohet regjistrimit në qarkullim rrugor, prandaj nuk ka bazë të kërkohet librezë e qarkullimit për këtë kategori te pajisjes. Dokumentacioni i dorëzuar me DUD është i mjaftueshëm për dëshmimin e pronësisë dhe përmbushjes së kërkesës së dosjes se tenderit, pra nuk kemi te bëjmë me traktor bujqësor qe dalin ne rruge, por me makina kositëse industriale per hapësira te gjelbra.

Prandaj i bëjmë thirrje Autoritetit Kontraktues qe kërkesat e dosjes se tenderit ti interpretoje dhe ti zbatoj ne menyre te sakte dhe te njëtrajtshme, ne përputhje me natyrën reale te pajisjeve te kërkuara, e jo ne menyre qe krijon paqartësi ne zbatimin e tyre gjate vlerësimit te ofertave

Lidhur me pretendimin për "Traktor me kositëse", qëndrimi i Autoritetit Kontraktues është kontradiktor dhe i pabazuar.

Në vendimin fillestar, Autoriteti Kontraktues ka arsytuar se EE-TECH SH.P.K. nuk ka dëshmuar librezën e qarkullimit dhe se nuk ka paraqitur kosën e traktorit sipas kërkesës së

Dosjes së Tenderit. Ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ndryshon tërësisht arsyetimin dhe pretendon se pajisja e ofruar është "makinë kositëse me ulëse" dhe jo "traktor me kositëse".

Një ndryshim i tillë i arsyetimit pas vendimit fillestar nuk është i pranueshëm, pasi EE-TECH SH.P.K. ka të drejtë të dijë arsyen konkrete dhe të qartë për të cilën është eliminuar oferta e saj. Autoriteti Kontraktues nuk mund të paraqesë arsye të reja gjatë fazës së rishqyrtimit për të justifikuar një vendim të marrë më herët. Pajisja e paraqitur nga EE-TECH SH.P.K. është pajisje për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe është dokumentuar me DUD, në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Dosja e Tenderit ka kërkuar "traktor me kositëse për hapësira të ndryshme", pa përcaktuar karakteristika të tjera teknike që do të dallonin një pajisje të tillë nga pajisjet profesionale për kositje të hapësirave të gjelbra.

Autoriteti Kontraktues ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe ka vendosur kritere të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara paraprakisht. Eliminimi i EE-TECH SH.P.K. mbi këtë bazë është i pabazuar.

### Arsyetimi i AK ne vendimin e pare:

7. Traktor me kositëse nuk keni aritur ta deshmoni librezën e qarkullimit sipas kërkesës së FDT-ës madje as kosen e traktorit sipas kërkesës por keni prezantuar makinë kosoiste me ulse me dud

### Arsyetimi i AK ne vendimin e dyte:

#### Pretendimi 7.

Pajisja e paraqitur me DUD si traktor me kositëse është pajisje pune për mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra dhe nuk i nënshtrohet regjistrimit në qarkullim rrugor, prandaj nuk ka bazë të kërkohej librezë e qarkullimit për këtë kategori të pajisjes. Dokumentacioni i dorëzuar me DUD është i mjaftueshëm për dëshminë e pronësisë dhe përbushjes së kërkesës së dosjes së tenderit, pra nuk kemi të bëjmë me traktor bujqësor që dalin në rrugë, por me makina kositëse industriale për hapësira të gjelbra.

Prandaj i bëjmë thirrje Autoritetit Kontraktues që kërkesat e dosjes së tenderit ti interpretojë dhe ti zbatoj në mënyrë të sakte dhe të njëtrajtshme, në përputhje me natyrën reale të pajisjeve të kërkuara, e jo në mënyrë që krijon paqartësi në zbatimin e tyre gjatë vlerësimit të ofertave

#### Përgjegje lidhur me pretendimin 7 të Operatorit Ekonomik është I PA BAZUAR

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar Traktor me kositëse për hapësira të ndryshme.

Gjatë vlerësimit të ofertës është konstatuar se ju, në PDF "Pajisjet", faqe 5, keni paraqitur makinë kositëse me ulëse, e cila nuk është pajisja e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Andaj, pajisja e ofertuar nuk përputhet me kërkesën minimale teknike të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Pretendimi i juaj lidhur me regjistrimin apo mosregjistrimin e kësaj pajisjeje nuk ndryshon faktin se nuk është ofertuar pajisja e kërkuar, por një pajisje tjetër.

### **Pretendimi 8.**

Lidhur me autolarjen vetëlëvizëse, pajisja është e mbështetur me dokumentacion përkatës DUD ndërsa kërkesa për librezë regjistrimi nuk është përcaktuar shprehimisht për këtë pajisje në dosjen e tenderit në mënyrë të veçantë, por është aplikuar interpretim i përgjithshëm i cili nuk është në përputhje me ndarjen e kërkesave të tenderit.

Pretendimi për "Autolarje vetëlëvizëse", arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është kontradiktor dhe i pabazuar.

Në vendimin fillestar, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se EE-TECH SH.P.K. nuk ka dëshmuar kërkesën e pretenduar dhe ka paraqitur DUD për një autolarje me ujë KÄRCHER të vendosur në rrota, e cila sipas tyre nuk ishte pajisje e regjistruar sipas kërkesës. Ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ndryshon arsyetimin dhe pretendon se pajisja e paraqitur nuk është "autolarje vetëlëvizëse", por vetëm makineri për pastrim me ujë.

Ky ndryshim i bazës së eliminimit tregon se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë një arsyetim të qartë dhe të qëndrueshëm për vendimin e marrë. Nëse arsyeja e eliminimit ka qenë se pajisja nuk përputhet me kërkesën teknike, kjo është dashur të përcaktohej dhe të arsyetohej në vendimin fillestar, e jo të ndryshohej gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokumentacion për pajisjen e deklaruar në ofertë, ndërsa në Dosjen e Tenderit është kërkuar "autolarje vetëlëvizëse", pa u përcaktuar karakteristika teknike shtesë që do të përcaktonin formën konkrete ose modelin specifik të pajisjes së kërkuar.

Pajisja e paraqitur nga EE-TECH SH.P.K. është makineri profesionale për pastrim me ujë dhe kryen funksionin për të cilin është kërkuar kjo pajisje, përkatësisht larjen dhe pastrimin me ujë. Autoriteti Kontraktues nuk mund të interpretojë në mënyrë kufizuese kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe të kërkojë karakteristika të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara paraprakisht.

Eliminimi i ofertës së EE-TECH SH.P.K. mbi bazën e këtij interpretimi është i pabazuar.

### **Arsyetimi i AK ne vendimin e pare:**

8. . Autolarje vetlevizese ju nuk keni arritur ta deshmoni me librez të qarkullmit sipas kerkeses se FDT-ës, por ka prezantuar dudin ,autolarje me uje karcher dhe keni ofruar dud R 20724 nje rimorkio, trailer makine per pastrim me uje e vendosur ne rrotae cila nuk është e regjistruar sipas kerkeses.

## Arsyetimi i AK ne vendimin e dyte:

### Pretendimi 8 nga OE

Lidhur me autolarjen vetëlëvizëse, pajisja është e mbështetur me dokumentacion përkatës DUD ndërsa kërkesa për librezë regjistrimi nuk është përcaktuar shprehimisht për këtë pajisje në dosjen e tenderit në mënyrë të veçantë, por është aplikuar interpretimi i përgjithshëm i cili nuk është në përputhje me ndarjen e kërkesave të tenderit.

Operatori Ekonomik në kërkesën për rishqyrtim pretendon se pajisja është dëshmuar me dokument pronësie (DUD) dhe se kërkesa për librezë regjistrimi nuk ka qenë e përcaktuar në mënyrë të veçantë. Ky pretendim nuk qëndron, pasi arsyeja e eliminimit nuk lidhet me dokumentacionin e regjistrimit, por me faktin se Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar pajisjen e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

### Përgjegjje lidhur me pretendimin 8 të Operatorit Ekonomik është I PA BAZUAR

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar Auto larje vetëlëvizëse.

Gjatë shqyrtimit të ofertës tuaj është vlerësuar në DUD-in e paraqitur në faqen 5, se keni prezantuar makineri për pastrim të automjeteve me ujë – KÄRCHER, e cila nuk është auto larje vetëlëvizëse, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, pajisja e ofertuar nuk përputhet me kërkesën minimale teknike të Autoritetit Kontraktues. Pretendimet lidhur me nevojën ose jo të librezës së regjistrimit janë të parëndësishme për këtë rast, pasi arsyeja e eliminimit është mospërputhja e pajisjes së ofertuar me kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertën bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga vetë ju si OE dhe ka vlerësuar me të drejtë se nuk është dëshmuar posedimi i Auto larjes vetëlëvizëse, sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit. Për këtë arsye, pretendimi i Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si I PA BAZUAR

## Pretendimi 9.

Sa i përket fshesës për trotuare, pajisja është e natyrës jo e regjistrueshme dhe është e dëshmuar me dokumentacion pronësie DUD, ndërsa kërkesa për librezë nuk është përcaktuar shprehimisht për këtë pajisje në Dosjen e Tenderit, andaj pretendimi për mungesë të pajisjes nuk qëndron

Në rast se për këto pretendime ka pasur paqartësi gjatë vlerësimit të ofertës, Autoriteti Kontraktues ka pasur në dispozicion bazën ligjore për të vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, nenin 59 të LPP-së, nenin 38 të Rregullores, lidhur me sqarimin e ofertave dhe kërkimin e informacioneve shtesë, si dhe nenin 7 dhe 5 të LPP-së që garantojnë trajtim të barabartë dhe transparencë në procesin e vlerësimit, duke mundësuar kështu verifikimin e plotë të dokumentacionit pa cenuar substancën e ofertës.

Lidhur me pretendimin për "Fshesë për pastrimin e trotuareve", arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është kontradiktor dhe i pabazuar.

Në vendimin fillestar, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se EE-TECH SH.P.K. nuk ka dëshmuar librezën e qarkullimit dhe se ka paraqitur vetëm DUD për një fshesë elektrike industriale. Ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ndryshon arsyetimin dhe pretendon se arsyeja e eliminimit nuk lidhet me dokumentacionin, por me faktin se pajisja e ofruar nuk është fshesë për pastrimin e trotuareve.

Ky ndryshim i arsyetimit tregon se Autoriteti Kontraktues nuk ka mbajtur qëndrim të qartë dhe të njëtrajtshëm gjatë vlerësimit të ofertës. Nëse problemi ka qenë mospërputhja e pajisjes së ofruar, kjo është dashur të përcaktohej dhe të arsyetohej në vendimin fillestar, e jo të ndryshohej gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

EE-TECH SH.P.K. ka dorëzuar dokumentacion për pajisjen e deklaruar në ofertë, ndërsa qëllimi i kërkesës në Dosjen e Tenderit ka qenë posedimi i një pajisjeje për pastrimin e trotuareve. Pajisja e paraqitur është pajisje profesionale për pastrim dhe kryen funksion pastrimi të trotuareve, prandaj vlerësimi i saj nuk mund të bëhet vetëm mbi bazën e emërimit, por duhet të merret parasysh funksioni dhe përdorimi i saj real.

Interpretimi i Autoritetit Kontraktues se pajisja e ofruar nuk përmbush kërkesën, pa një përcaktim të qartë teknik në Dosjen e Tenderit, është i pabazuar dhe eliminimi i ofertës së EE-TECH SH.P.K. nuk është i arsyetuar.

### Arsyetimi i AK në vendimin e parë:

**9. Fshis për pastrim të trotuareve, nuk keni arritur ta deshmoni librezën e qarkullimit por keni prezantuar vetëm dudin, fshesë elektrike me vete motorr të kontrolluar, fshesë elektrike industriale.**

### Arsyetimi i AK në vendimin e dytë:

**Përgjegje lidhur me pretendimin 9 të Operatorit Ekonomik është I PA BAZUAR**  
Operatori Ekonomik në kërkesën për rishqyrtim pretendon se pajisja është dëshmuar me dokument pronësie (DUD) dhe se nuk ka pasur obligim për dorëzimin e librezës së regjistrimit. Ky pretendim nuk qëndron, pasi arsyeja e eliminimit nuk lidhet vetëm me mungesën e librezës së regjistrimit, por me faktin se Operatori Ekonomik nuk ka ofruar pajisjen e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar fshesë për pastrimin e trotuareve. Gjatë shqyrtimit të ofertës është konstatuar se Operatori Ekonomik, në PDF "Pajisjet", faqe 9, ka paraqitur fshesë me rrymë, me motor të vetëkontrolluar, me fuqi deri në 1500 W – fshesë elektrike industriale, e cila nuk përputhet me pajisjen e kërkuar në Dosjen e Tenderit. Pajisja e ofruar nga ju nuk është fshesë për pastrimin e trotuareve, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, por një pajisje tjetër me karakteristika dhe funksion të ndryshëm. Për këtë arsye, Operatori Ekonomik nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës minimale teknike të Dosjes së Tenderit. Po ashtu, pretendimi se Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë sqarime sipas nenit 59 të LPP-së është i pabazuar. Neni 59 i LPP-së lejon vetëm sqarimin e dokumenteve të dorëzuara dhe nuk lejon plotësimin, zëvendësimin apo ndryshimin e pajisjeve të ofruara pas afatit për dorëzimin e ofertave. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me paqartësi, por me faktin se është ofruar një pajisje që nuk përputhet me kërkesën e Dosjes së Tenderit. Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe pretendimi juaj refuzohet si I PABAZUAR

Në përfundim, EE-TECH SH.P.K. se mosmundësimi i qasjes në dokumentacion ka cenuar të drejtën tonë për verifikim të plotë të procesit të vlerësimit. Për këtë arsye, në rast të kthimit të procedurës në rivlerësim, kërkojmë që qasja të realizohet përmes platformës së e-Prokurimit, si platforme kryesore zyrtare, me qëllim që i gjithë procesi të jetë transparent dhe i kontrollueshëm.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të vendimit fillestar dhe përgjigjes ndaj kërkesës për rishqyrtim vërehet se Autoriteti Kontraktues ka dhënë arsye të ndryshme për eliminimin e pajisjeve të njëjta. Në disa raste fillimisht është pretenduar mungesë dokumentacioni ose librezë, ndërsa më pas është ndryshuar arsyetimi duke u bazuar në mospërputhje teknike të pajisjeve.

Duke marrë parasysh këto rrethana, dhe në pamundësi të qasjes në dokumenta, kërkojmë që Eksperti dhe Paneli i OSHP-së të shqyrtojnë nëse ndaj operatorit ekonomik të shpallur fitues është zbatuar i njëjti standard i vlerësimit dhe nëse kërkesat e Dosjes së Tenderit janë interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë..

**Sqarimi i tenderit-** Neni 59.2 i LPP-së lejon AK-në të kërkojë sqarim me shkrim për çdo aspekt të tenderit, me kusht që të mos lejohet ndryshim material. Neni 59.4 lejon që një tender të konsiderohet i përgjegjshëm kur përmban vetëm gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material, ose devijime të vogla pa efekt material.

-Neni 38.3 i Rregullores lejon kërkimin dhe pranimin e informatave ose dokumenteve që mungojnë, kur ato objektivisht paraqesin prova të mjaftueshme që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit të tenderimit. Neni 38.4 kërkon kushte të njëjta për të gjithë OE-të dhe kërkimin e informatave për qartësimin e deklaratave ose certifikatave të paqarta; vlefshmëria e ofertës mund të vendoset vetëm pas përgjigjes dhe shqyrtimit të dokumenteve

AK nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë **OE me çmim me te larte**. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 6 i LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si OSHP që të nxjerrni

### **VENDIM**

**APROVOHET**, ankesa e EE-TECH SH.P.K..

**ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së, rekomandimi për dhënie dhe lënda te TE KTTHEHET NE Rivleresim

**Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.**

### **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Deme te konsiderueshme

### **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*